

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 25-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 31.05.2024**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:**  
Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:/**

**Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga shërbimi profesional përmes lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, Katerina Donevska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 25-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 12:00 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski njoftoj se për shkak të problemeve teknike me video-lidhjen, votimi i z.Trajçev do të transmetohet përmes audio-linkut.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota „pro“, miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 24-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 30.05.2024.
2. Propozim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV SHENJA SHPKNJP nga Shkupi.
3. Propozim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të RA Galaksi nga Kavadari për shkelje të nenit 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të RA PRO-FM nga Gostivari për shkelje të nenit 15 paragrafi (1) nga Ligji për Media.
6. Të ndryshme.

## **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi dhe me 5 vota „pro“ dhe një votë abstenim nga z. Trajçev, miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 24-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 30.05.2024, me tekstin e propozuar.

## **Pikat 2 dhe 3**

Z. Trajçevski shpjegoi se do të japë një shpjegim hyrës për Propozimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV SHENJA SHPKNJP nga Shkupi dhe për Propozimin për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV SHENJA SHPKNJP nga Shkupi, sepse kemi të bëjmë me shkelle të nenit të njëjtë nga LSHMAAV. Shpjegoi se për të dy transmetuesit e përmendur ka filluar procedura për heqjen e lejes, për shkak se, në afatin e përcaktuar ligjor nuk e kanë kryer pagesën në përputhje me faturën e dorëzuar nga ana e Agjencisë për kompensimin vjetor për transmetim televiziv dhe radio. Në afatin plotësues prej 15 ditësh që u është dhënë nga Këshilli në bazë të Ligjit, të dy transmetuesit e kanë kryer pagesën dhe për këtë arsye propozohet ndërprerja e procedurës.

### *Votimi për Pikën 2*

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerje të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR TV SHENJA SHPKNJP nga Shkupi, PA1 nr.08-778 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer me nr.05-2443/2 datë 30.05.2024, SHTR TV SHENJA SHPKNJP nga Shkupi, kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv e pagoi plotësisht, sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0138 datë 11.04.2024.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

### *Votimi për Pikën 3*

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerje të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, PA1 nr.08-301 datë 01.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer me nr.05-2574/1 datë 30.05.2024, SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio e pagoi plotësisht, sipas faturës së dorëzuar me nr.2024-100-0137 datë 03.04.2024.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

## **Pikat 4 dhe 5**

Bashkëpunëtori i lartë nga Njësia për planifikim strategjik Katerina Donevska, shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të RA Gallaksi nga Kavadari për shkelle

të nenit 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media dhe Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të RA PRO-FM nga Gostivari për shkelje të nenit 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media. Shpjegoi se të dy transmetuesit nuk e përmbushën detyrimin ligjor, sipas të cilit obligohen jo më vonë se data 31 mars të vitit aktual t'i dorëzojnë Agjencisë të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/redaktorët, burimet e financimit në 2023, të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në total nga ofrimi i aktivitetit në 2023 dhe për (audiencën)shikueshmërinë mesatare në 2023. Ajo deklaroi se sektori ka kontaktuar disa herë me mediat për t'i përkujtuar për obligimin, por meqënëse nuk ka përmirësim nga ana e tyre, propozohet që t'u shqiptohet masë vërejtje publike.

#### Votimi për Pikën 4

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.03-2121/1 datë 29.04.2024, njëzëri konkludoi që ndaj SHTR GALLAKSI-2002 SHPKNJ Kavadar t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media, sepse drejtuar Agjencisë nuk ka dorëzuar të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin-përgjegjës/redaktorët, burimet e financimit në 2023, të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në total nga ofrimi i aktivitetit në 2023 dhe për shikueshmërinë(audiencën) mesatare në 2023.

Në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Urdhërohet që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e saj me dispozitat e Ligjit për Media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas përfundimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

#### Votimi për Pikën 5

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr.03-2120/1 datë 29.04.2024, njëzëri konkludoi që SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media, sepse drejtuar Agjencisë nuk ka dorëzuar të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës/redaktorët, burimet e financimit në 2023, të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në total nga ofrimi i aktiviteteve në 2023 dhe për shikueshmërinë mesatare në 2023.

Në pajtim me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Urdhërohet që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e saj me dispozitat e Ligjit për Media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas përfundimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmenduar ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

#### **Pika 4**

#### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**